



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0410

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Vedat Poterqoi - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së OE “TSR SH.P.K.”, me seli në Prishtinë, kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri” me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 05/09/2023, mori

Vendim

1. Aprovohet, pjesërisht si e bazuar ankesa e “TSR SH.P.K”, me nr. 2023/0410, e datës 17/06/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri”, me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri”, me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga paneli shqyrtues.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 10.05.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Me datën 16.06.2023, AK- Komuna e Prishtinës, ka publikuar Formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara. Hapja e ofertave ishte paraparë të bëhet me datë 20.06.2023, për aktivitetin e prokurimit “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri”, me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1.

Me datë 28.05.2023, Operatori Ekonomik “TSR SH.P.K”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, të cilën e kërkesë e refuzon si të pa bazuar Autoriteti Kontraktues, vendi i Komunës së Prishtinës.

Me datën 19.06.2023, Operatori Ekonomik “TSR SH.P.K”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 0410/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë publike kornizë me një Operator Ekonomik, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 800 00.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP. Palët janë njoftuar me raportin e ekspertizës me datë: 04 gushtë 2023.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 04.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa OE “TSR SH.P.K., të aprovohet pjesërisht si e bazuar.
- të anulohet njoftimi për kontratë dhe rekomandojmë AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “TSR” SH.P.K.

Pretendimi 1 (LPP/Neni 1: Qëllimi): Lidhur me arsyet për çfarë mendojmë se AK ka bërë shkelje të këtij neni është pasi që të gjitha kërkesat janë bërë në mënyrë specifike sipas produkteve të kompanisë LA SEMAFORICA. Eksperti Shqyrtues, sqaron se kur iniciohet një aktivitet i prokurimit, AK -ja gjithmonë duhet të ketë parasysh qëllimin e LPP-së, dhe në rastin konkret AK është dashur të respektoj në tersi paragrafët të Nenit 1 të LPP-së.

Pretendimi 2 (LPP/Neni 6:Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi): Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues në pjesën sipër i referohet Nenit 6 i cili ka të bëjë me Ekonomicitetin/efikasitetin, ndërsa në shtjellim të pretendimit ankimor i referohet në shkelje të Nenit 7 Barazia në trajtim/Jo diskriminimi. Këtë pretendim ankimor e determinon si të bazuar pretendimi ankimor nr.5 lidhur me specifikat teknike, andaj AK-ja gjatë plotësim/ndryshimit të DT-së duhet të ketë parasysh Nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 3 (Neni 28 i LPP-Së Specifikimet Teknike) Këtu AK bën shkelje te pikës 2 te këtij neni i cili thotë citojmë; Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Andaj AK duke mos vendos specifika ndërkombëtare apo duke mos lejuar edhe produkte ekuivalente sipas këtyre specifikave bën shkelje te kati neni, Pastaj AK duke u fokusuar ekzakt vetëm ne specifikat teknike te këtij Prodhuesi favorizon dhe diskriminon qe ne start OE tjerë te cilët shprehin dëshirën te marrin pjesë ne ketë tender.

Pretendimi 4 (Neni 108/A i LPP-së Zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve), në lidhje me pretendimin ankimor ku OE ankues thekson se AK ka bërë shkelje të këtij neni në rastin e shqyrtimit shkel e shko, apo me mire me thënë mos shqyrtimit hiq të kërkesës për rishqyrtim. Eksperti Shqyrtues sqaron se AK-ja i ka dhënë përgjigje OE ankues në kërkesën për rishqyrtim me dt. 07.06.2023 ku dhe i ka rekomanduar këshillën juridike që pala e pa kënaqur mund të parashtrij ankesë në OSHP brenda 10 ditëve, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar

Pretendimi 5 AK ka shkel edhe Nenin 20 i RRUOPP- Specifikimet teknike: AK duke vendosur specifikime teknike siç i sqaruar me lart ka ber shkelje edhe të këtij neni dëshmitë qe Specifikajonet teknike qe vendos AK ne ketë DT janë identike me specifikajonet e produkteve te prodhuesit La Samoforica ja bashkëngjisim kësaj kërkesë për rishqyrtim Specifikat teknike te AK Dëshmia nr. 4 ndërsa specifikat teknike te prodhuesit Dëshmia nr. 3 dhe broshurat dëshmia nr. 1 dhe 2; këtu vërehen shumë qartë shkeljet e AK me rastin e vendosjes se specifikajoneve teknike te vetëm një prodhuesi pa mundësuar qe mund te jen edhe specifikajone tjera ekuivalente apo specifikajone siç thotë Nenin 20 i RRUOPP citojmë “Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik”.

Eksperti Teknik bazuar ne analizimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit qe ka pasur ne dispozicion ka vërejtur se specifikat teknike qe AK ka kërkuar për ketë aktivitet janë:

Përshkrimi Teknik i semaforëve(laternave) - Spec. qe ka kërkuar AK

Përshkrimi Teknik I semaforeve (laternave)				
Materiali i shtepizes se laternave	Polycarbonate (Bayer, Makrolon)			
Rezistenca ndaj goditjeve	Acc.to EN60598-1 Class IR3 Acc. to EN12368:2006			
Shkalla e mbrojtjes	IP55 Acc. to EN60529 Class IV Acc. to EN12368:2006			
Ngjyrat e Laternave	Kuq, Verdhe, Gjelbert,			
Diametri	200mm and 300mm qe mund te montohen se bashku			
Laterna	200mm and 300mm Starled2 Modul			
Temperatura punuese	-40°C +60°C sipas. EN60068-2-1-14, Class A,B,C sipas EN12368:2006			
Jetegjatesia	(10 years) > 100.000 hours			
Rezistenca ndaj goditjeve	sipas EN60068-2-64			
Rezistenca ndaj nxehtesise	sipas EN60068-2-30			
Diametri i drites sinjalizuese	Ø 200 mm	Konsumi vjetor	Ø 300 mm	Konsumi vjetor
Konsumi i energjise me drite LED	7 W	61 kW/h	7 W	61 kW/h
Kursimi i energjise krahasur me drita inkadeshente		90 %		93%

Gjithashtu kemi analizuar specifikat e broshurës qe OE ankues ka dorëzuar si dëshmi me rastin e dorëzimit të ankesës, Specifikat teknike nga Dëshmia 2 - Brochura La semaforica janë si ne vijim:

TECHNICAL FEATURES

Material	Aluminium Bayer® Makrolon® UV-stabilized polycarbonate
Impact Resistance	Acc.to EN60598-1 Class IR3 Acc. to EN12368:2006
IP rating	IP55 Acc. to EN60529 Class IV Acc. to EN12368:2006
Standard Colours	Black (RAL 9005) Green (RAL 6009) Gray (RAL 7032) Yellow Orange Other colours or combination front-backside available on request
Diameters	200mm 300mm
Optic	200mm and 300mm Starled2 Modules
Temperature range	-40°C +60°C Acc. to EN60068-2-1-14 Class A,B,C Acc. to EN12368:2006
Vibration resistance	Acc. to EN60068-2-64
Damp heat resistance	Acc. to EN60068-2-30
Signal light with symbol	Class S1
Background screen of signal light	Class C1

ENERGY SAVING

TRAFFIC SIGNAL HEAD	Ø 200 mm	yearly consumption	Ø 300 mm	yearly consumption
Consumption with Incandenscent lamps	70 W	613 kW/h	100W	876 kW/h
Consumption with Leds	8 W	70 kW/h	8 W	70 kW/h
Energy saving		88,5%		92%

Po ashtu autoriteti kontraktues ne përshkrimin teknik qe ka ngarkuar ne sistem ka cekur qe pajisjet munde te jene ekuivalente, me poshtë po japin një shembull nga ky përshkrim për pajisjen “Inventori për furnizim me energji elektrike ose ekuivalent”

Inventori per furnizim me energji elektrike ose ekuivalent



Bazuar ne atë qe thamë me larte vërehet se specifikat e semaforeve qe janë kërkuar nga AK janë po thuajse te njëjta me ato te prodhuesit LA SEMAFORICA qe ka dorëzuar OE ankues deri te

kolona e “diametri i dritës sinjalizuese”, ndërsa specifikat te konsumi i energjisë me drite LED dhe kursimi i energjisë krahasuar me drita inkadeshente nuk është i njëjti me specifikat e kërkuara nga AK ose është bërë ndonjë gabim teknik ne përpilimin e specifikave pasi qe konsumi i energjisë me dritë Led është shume e vogël vetëm 7 W.

Eksperti teknik po ashtu ka analizuar edhe përgjigjen e AK-së te datës 16.06.2023 ne kërkesën për informacion shtesë ku e sqaron se Specifikat e produkteve te kërkuara pranohet te jene me karakteristika ekuivalente ose me te avancuara ne raport me kërkesat e specifikimit teknik ku po i cekim vetëm disa nga to:

- Kontrolloret duhet te operojnë ne mënyrë te pavarur dhe te ndërlidhur mes vete përmes qendrës komunikimi me te cilën është i nevojshme përmes protokolleve standard te komunikimit për pajisje te tilla dhe te jete kompatibil me kontrolleret ekzistues,
- Platforma centralizuese pranohet te jete ekuivalente ose me e avancuar dhe te jete compatibile me nyjet ekzistuese,
- Softueri i kërkuar ne pozicionin 62 duhet të ofroje mundësi të monitorimit te njeje te reja de te mundësojë integrimin e njeje ekzistuese. Pranohen softuer te cilët i përmbushin karakteristikat minimale ose me te avancuar te specifikimit teknik,
- Kompletimi i qendrës se monitorimit te semaforëve nënkupton furnizimin dhe montimin e pajisjeve për versionin bazik te qendrës monitoruese,
- Pranohen të gjitha produktet qe i plotësojnë kërkesat e specifikimit teknik për transferim të dhënave mes pajisjeve te trafikut dhe qendrës se monitorimit.

Po ashtu edhe ne vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim ku AK citon se “ specifikat teknike te dosjes se tenderit janë te hartuara pikërisht duke i respektuar rregullat dhe standardet ndërkombëtare si dhe konform Ligjit te Prokurimit Publik te Republikës se Kosovës. Te njëjtën kohe është mundësuar qe për produktet e kërkuara te ofertohej me prodhime ekuivalente ose me te avancuara (shih specifikimin teknik) te cilat i plotësojnë prodhuesit konform standardeve te aplikuara te kualitetit dhe te cilat janë compatible me pajisjet ekzistuese semaforike. Edhe njëherë ju potencojmë se ne specifikimet teknike te dosjes se tenderit për produktet semaforike te kërkuara është e potencuar që pajisjet të jene: me karakteristika minimale ose me e avancuar dhe rrjedhimisht pranohen edhe produktet ekuivalente siç është e potencuar ne dosje te tenderit”

Gjithashtu sqarojmë se shumica e produkteve janë me standarde dhe kode te caktuara dhe si rrjedhoje mund te jene produkte nga prodhues te ndryshëm, mirëpo sipas analizës se përshkrimit teknik ka pozicione ku duhet tu përmbahen specifikave te kërkuara pasi qe sipas analizës se bërë shihet se AK ka sisteme ekzistuese/aktuale ne përdorim te cilat kërkojnë qe produktet e ofruara nga operatorët ekonomik te jen compatible me sistemin ekzistues/aktual.

Andaj rekomandojmë qe AK të bëjë me shume sqarime ne Dosjen e Tenderit dhe ne NjK lidhur me ato pozicione ku janë te obligueshme prodhues te caktuar ne mënyrë qe te jen compatible me sistemin ekzistues/aktual qe Komuna e Prishtinës ka te instaluar si dhe brenda mundësive te mos behën kufizime ne specifikimin e produkteve për pozicionet tjera.

Bazuar në sqarimet dhe dëshmitë e lartpërmendura rezulton se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për kontratë dhe rekomandojmë që AK të bëjë me shume sqarime(korrigjime) ne Dosjen e Tenderit dhe ne NJK lidhur me ato pozicione ky janë te obligueshme, prodhues te caktuar ne mënyrë qe te jenë kompatible me sistemin ekzistues/aktual që Komuna e Prishtinës ka te instaluar.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues profesional dhe atij teknik dhe mendimi i tyre janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE “TSR SH.P.K”, të aprovohet pjesërisht si e bazuar, obligohet AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës që ta anuloj njoftimin për bëjë zgjatjen e afatit për dorëzim të ofertave si dhe ta bëjë përmirësimet/sqarimet në dosjen e tenderit konform rekomandimit të ekspertit shqyrtues.

Gjatë përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes, PSH merr në konsideratë qëllimin AK-ve që kontrata specifike kërkojnë kompani profesionale si shkak i natyrës së tyre si dhe për faktin e punëve specifike konform vlerës së parashikuar, por PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet te jenë padrejtësisht te rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme te cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - TSR SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: